



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

BASHKIA MAT  
NJËSIA E PROKURIMIT

Burrel, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR, E  
THJESHTUAR – PUNË”**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

***“Rikonstruksion i Tregut Industrial Burrel”***

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**45000000-7** Punë ndërtimi.

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**7 083 244.7** (*shtatë milion e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e katër pikë shtatë*) lekë pa TVSH, ndarë për vitin 2023 në vlerën: **1 700 000** (*një milion e shtatëqind mijë*) lekë pa TVSH, nga grandi i bashkisë: 1 020 000 (*një milion e njëzet mijë*) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat: 680 000 (*gjashtëqind e tetëdhjetë mijë*) lekë pa TVSH, për vitin 2024 në vlerën: **2 666 666.66** (*dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH, nga grandi i bashkisë: 1 333 333.33 (*një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat: 1 333 333.33 (*një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2025 në vlerën: **2 716 578.04** (*dy milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë zero katër*) lekë pa TVSH, nga grandi i bashkisë: 2 066 666.67 (*dy milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë*) lekë pa TVSH dhe nga të ardhurat: 649 911.37 (*gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë*) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, dhe nenit 93 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Mat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2019, 2020**, dhe **2021**, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së këruar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2019, 2020**, dhe **2021**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktiveve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2022** për adresën ku ai ushtron aktivitetet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku nëse kualifikohet, përpala publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*

### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **ninin 77 pika 1/b** dhe **3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) gjendjen ekonomike dhe financiare;... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të*

*caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund tē kérkojnë që operatorët ekonomikë tē japid informacione në bilancet e tyre vjetore që tē tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kérkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund tē tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar tē kontratës.”*

Në **ninen 43** “Kérkesat pér kapacitetet ekonomiko - financiare” tē Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Pér miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër tē tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, pér tē provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kérkon kopje tē deklaratave tē xhiros vjetore tē realizuar nga operatori ekonomik pér një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kérkohet operatorëve ekonomikë nuk mund tē tejkalojë:  
*c) 40 % tē vlerës së përllogaritur tē kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulencë”.*
3. *Kérkesa pér plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në tē paktën një vit tē periudhës së kérkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund tē kérkojë që operatorët ekonomikë tē japid informacione në bilancet e tyre vjetore, pér një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që tē tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kérkohen një ose dy bilance, kérkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kérkuara nuk ka rapport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Ndërsa në **ninen 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” tē Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Pér miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër tē tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve tē këtij bashkimi duhet tē përmbushë kérkesat e parashikuara në nin 76, tē LPP-së, dhe ato tē përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kérkesat pér kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet tē përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, tē përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje tē përcaktimeve ligjore dhe nënligjore tē sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Pér kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Pér tatimin mbi tē ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Pér auditimin ligjor, organizimin e profesionit tē audituesit ligjor dhe tē kontabilistik tē miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Pér deklarimin e detyrueshëm tē deklaratave tatimore dhe tē dokumenteve tē tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Pér tatimin mbi tē ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që tē kérkojë xhiron vjetore pér vitet financiare 2019, 2020, dhe 2021 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në tē paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kérkuar, duhet tē jetë jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar tē kontratës që prokurohet dhe pasqyrat financiare pér tre vitet e fundit (2019, 2020, 2021) tē konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që tē dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars tē vitit pasardhës

bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ndërsa bilancet duhet të paraqiten nga secili anëtar.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vëndet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

**Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kritere janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.**

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **30%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **100%** e fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rast se punimet jane kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. *Konratën e Sipërmarrjes,*
  - ii. *Situacionin përfundimtar të objektit*
  - iii. *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
  - iv. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
  - v. *Certifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*

- vi. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- vii. *Në rast se kontrata e ngashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

b) **Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat:** Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
- v. *Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- vi. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nemin 77 pika 1/c** dhe **4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, **autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

**Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”**

Në **nemin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 5** dhe **8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetetime të lëshuara nga një ent publik, për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përbushjen e suksesshme të punëve. Në

rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore **dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.**

**8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”**

Ndërsa në **ninen 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”** (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “*Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve: i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*”

Ndërsa në **ninen 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”** (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përbushë kërkesat e parashikuara në nin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përbushen nga i gjithë bashkim, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të percaktuara në aktmarrëveshje.**

**Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të ninjtë 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përbushë këtë kusht.”**

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur ne DST. Fjala “**kërkon**” nënkuption se këto kriteret janë kritere detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

**Njësia përcaktoj kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.**

**Referuar natyrës së kontratës për punë publike, njësia vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacionit ligjor të zbatimit të punimeve, bazuar në ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”** (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas ninjtë 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas

dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b të VKM-së, të paraqesin kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit (*si dhe çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve*), për të vërtetuar faktin, nëse operatori ekonomik pjesëmarrës zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës në masën e përcaktuar sipas nenit 55 pika 4/a të VKM-së, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, pasi në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, si dhe në faturat tatumore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

**Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kostoshtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.**

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licencë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licencë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licencë:**
  - **Kategoria NP-2 (Ndërtime civile dhe industriale) – Klasifikimi A**
  - **Kategoria NP-3 (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada) – Klasifikimi A**
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licencë:**
  - **Kategoria NS-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve) – Klasifikimi A**
  - **Kategoria NS-2 (Impante hidro-sanitare, kuzhina, lavaneri, mirëmbajtja e tyre) – Klasifikimi A**
  - **Kategoria NS-4 (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese) – Klasifikimi A**
  - **Kategoria NS-14 (Impante të brëndëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.) – Klasifikimi A**

\* *Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkua të ekzekutimin e kontratës.*

\* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

### 2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001** (*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë*) e përditësuar
- **ISO 14001** (*Për sistemin e menaxhimit të mjedisit*) e përditësuar
- **ISO 45001** (*Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) **ose ekuivalente me të, të njojur nga Standartet Shqipëtare**, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të janë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të janë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, ISO-t duhen plotësuar nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.*

### 2.3.4 Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:

- **Dritare d/alumini**
- **Plaka trotuari**
- **Bojë hidroplastike**

#### Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

1. Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose **Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj)** të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, dhe të jetë e vlefshme vetëm për këtë objekt prokurimi deri në realizimin e plotë të punimeve.

2. **Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

**Shënim:** Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. **Certifikatë/ Deklaratë konfirmiteti CE/ Çertifikatat e cilësisë** sipas standardeve ose **Dëshmi të testimeve zyrtare të kryera**, të lëshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të produhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuar.

## **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a, 2 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimitarë profesionale;... c) aftësinë teknike dhe profesionale;... ”

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

**2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimitari profesional, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie ”**

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Në nenin **39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 6/a** dhe **8** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjera përcaktohet se, citojmë:

**“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimitarë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:**

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;**
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës;**

**8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. ”**

Në nenin **40** **pika 6/ b** dhe **c** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjera përcaktohet se, citojmë:

**“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:**

- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose**
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikit teknike.”**

Gjithashtu në **nenin 44** “Kërkesat e cilësisë” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se,

citojmë: “*1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkrajnë me karakteristikat e kërkua, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Në mbështetje të përcaktimave ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

1. Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” (të ndryshuar), neni 8 i tij në të cilin përcaktohet se, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore, dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 42, datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*” në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm subjekte të licensuar, sipas kësaj rregulloreje, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, me **kategoritë e kërkua** të përcaktuara sipas llojit **dhe nënlojtit të objektit të punimeve, ku sipas preventivit të punimeve OE duhet të disponojnë: kategorinë NP-2 (Ndërtime civile dhe industriale)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*Shtresë betoni..., Punime shtresash..., pllaka trotuari... etj.*); **kategorinë NP-3 (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*shtresë llüstër..., hidroizolime..., lyerje... etj.*); **kategorinë NS-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*Punime prishje shtresa...*); **kategorinë NS-2 (Impante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*Punime në tualete...*); **kategorinë NS-4 (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik...)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*Ulluqe shkarkimi..., veshje me panele..., tavane plastik i varur..., dritare d/alumini... etj.*), dhe **kategorinë NS-14 (Impante të brëndëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.)** në lidhje me zërat e punimeve në preventiv (*Punime Elektrike...*), si dhe **klasifikimin** në nivelet e kërkua për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcione me objektin e kontratës.
2. Njësia e prokurimit gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standardeve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime, ku më hollësish:

- ISO 9001, është kërkuar me qëllim *vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik*, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.
  - ISO 14001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik *për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi*, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.
  - ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik *në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor*, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkësë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.
3. Gjithashtu, njësia e prokurimit bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përvëç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të janë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K., nëse këto materiale për të cilat op. ek. pjesëmarrës është i autorizuar për t'i ofruar ose ka marrëveshje bashkëpunimi, janë në përputhje me specifikimet teknike e standartet të materialeve të kërkuar për këtë procedurë prokurimi.

**Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet profesionale e teknike si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi te gjitha ato i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre përbushjen me sukses të kontratës.**

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **20 (njëzet) punonjës** për periudhën **3 (tre) muajt** e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përparrë publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.

2. Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatinore për periudhën e mësipërme.

**2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:**

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë notoriale pune (të vlefshme), diplomë, CV, librezë pune si dhe të figurojë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.5, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpala publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

- b) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi **6 (gjashtë) punonjës** të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi – jo më pak se 1 (një) punonjës
- Karpentier – jo më pak se 1 (një) punonjës
- Suvatues – jo më pak se 1 (një) punonjës
- Elektriçist – jo më pak se 1 (një) punonjës
- Hidraulik – jo më pak se 1 (një) punonjës
- Hekurkthyes – jo më pak se 1 (një) punonjës

\* Për përbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpala publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme, çertifikatë/ dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik *lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar)*, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.5.

- c) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, dëshmi/ çertifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.5, punonjës me specialitetin si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **punonjës** të disponojë çertifikatë/dëshmi si “**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë**” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 “**Për sigurinë dhe shëndetin në punë**” dhe V.K.M-në nr. 312, date 05.05.2010 “**Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (i ndryshuar**

- Minimuni **1** (*një*) **punonjës** që përmbush kriteret për të qenë “*Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave*”.
- Minimuni **2** (*një*) **punonjës** të specializuar dhe çertifikuar *për kryerjen e punimeve në lartësi*.

Disponimi i stafit mbështetës do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përparrë publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

- d)** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (*nga Administratori i shoqërisë*) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, *dhe në rast se kualifikohet, përparrë publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Librezë pune (përkatëse)
  - CV përkatëse
  - Kontratë notariale pune e vlefshme (përkatëse)
  - Diplomë

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nemin 77** të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>*” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

**4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.**

**5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kritereve.”**

Në **nemin 39** “*Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike*” **pika 6/b** dhe **c** dhe **8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “**6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:**

- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Ndërsa në **ninen 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”** (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përbushë kërkesat e parashikuara në nin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

Në mbështetje të përcaktiveve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t'u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkuption se këto kriteret janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e një punësimi mesatar jo më pak se **20 (njëzet) punonjës**, duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, dhe natyrën e punimeve objekt kontrate, si dhe në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së, dhe nenit 39 pika 6/c të VKM-së, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përllogaritjen e numrit të punonjësve, për realizimin e objektit sipas kushteve të parashikuara në Shtojcën 5 “*Formulari i Specifikimeve teknike*” është bërë një analizë bazuar tek faktorët si: zérat e punimeve dhe orët e punës, volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, dhe afatit të kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së, ligjet nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” si dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit ka përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përbushjen e këtyre kushteve, dokumenta të cilat nuk përbëjnë kosto shtesë për plotësimin e dokumentacionit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, **ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon**, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

2. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe vërtetimin e aftësisë **organizative**, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njësia e prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në stafin e tyre të drejtuesve teknik, minimumi 1 (një) Inxhinier Ndërtimi. Kërkesa specifike për inxhinierin e kerkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivit të punimeve (*nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik*), ku më hollësishët është kerkuar inxhinieri i ndërtimit, me qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi strukturore dhe rikonstruksioni si: *prishje shtresash, shtresa betoni, shtresa hidroizolimi dhe rifiniture, punime e sistemime të jashtme etj.*, ku është e nevojshme suporti teknik i inxhinierit të ndërtimit dhe ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier, ku për vërtetimin e tij, duhet të paraqitet dokumentacioni i kerkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 42, datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”.
3. Referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, të cilët duhet të janë me specialitetin: **Teknik ndërtimi, Karpentier, Suvatues, Elektriçist, Hidraulik, Hekurkthyes, pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi**, ku ndër të tjerash, është kerkuar që të paraqesin certifikatat/ dëshmitë e sigurimit teknik *lëshuar nga Inspektoriat i Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar)*, për vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, si dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit teknik për punën në ndërtim**, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.
4. Referuar natyrës së punimeve që do të kryhen, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të disponojnë në stafin e tyre personelin e kualifikuar/ certifikuar:
  - Në lidhje me kerkesën për disponimin si pjesë të stafit të punësuar 1 (një) punonjës që disponon certifikatë/dëshmi si “**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë**”, njësia e prokurimit vlerëson se, kjo kerkese është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi ky punonjës i certifikuar **nevojitet për përshtatjen e kantierit** sipas fazave **të punimeve, mbajtjen e kantierit** në kushte të rregullta, kontrollin e materialeve dhe pajisjeve të punës me qëllim eleminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë dhe/ose shëndetin e punëmarrësve, si dhe verifikimin e zbatimit të planit të sigurisë dhe koordinimit gjatë zbatimit të punimeve kerkesa kjo në zbatim të nenit 9 dhe 10 të ligjit të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, dhe nenit 2, 5 dhe 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”*”.
  - Kerkesa për disponimin e 1 (një) punonjësi që përbush kriteret për të qenë **“Ekspert për Ndihmën e parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”**, është një kerkese në përputhje me

natyrën e punimeve, dhe vendodhjes së punimeve, ku njësia e prokurimit vlerëson se, bazuar në ligjin 10 237, dt.18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, 05.05.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”,*” është i nevojshëm disponimi nga operatorët ekonomikë i **punonjësit** të certifikuar si “*Ekspert për Ndihmën e Parë dhe Ndërryryjen ndaj Emergjencave*”, **me qëllim instruktimin e punonjësve dhe dhënien e ndihmës së parë** në rast rrezikimi të jetës së punonjësve të angazhuar në kryerjen e punimeve objekt kontrate.

- Kërkesa për disponimin e 2 (*dy*) punonjësve të specializuar dhe certifikuar ***për kryerjen e punimeve në lartësi, njësia e prokurimit vlerëson se kjo kërkesë është e domosdoeshme, duke qënë se bazuar në preventivin e punimeve kemi të bëjmë me kryerje të punimeve në lartësi (*mbi 2 m*) me anë të skelerive, shkallëve etj., për punimet që do të kryhen në tarracë dhe fasadat e objektit,*** kërkesë kjo në zbatim të përcaktimave të nenit 11 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”,*” ku për përbushjen e kësaj kërkesë duhet të paraqesë Çertifikatat përkatëse të punonjësve që do të angazhojë për kryerjen e këtyre punimeve.
5. Po ashtu, me qëllim ndërtimin e objekt kontratës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, në zbatim të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*” njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt me anë të një deklarate, i cili të jetë i përfshirë në licënsimin e shoqërisë, dhe duhet të ndjekë punimet që do të kryen në objektin e kontratës.

**Punonjësit, specialistët, inxhinierët dhe stafi i kualifikuar të kerkuar i shërbijnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kerkuar për t'u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.**

### 2.3.7 (Makineri, Pajisje)

- a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;**

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues me vinç me kapacitet mbajtës min. 7 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
2.	Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1 - 3.5 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
3.	Depozitë uji ( <i>jo më pak se 2000 litra</i> )	<i>jo më pak se 1 copë</i>

<b>4.</b>	Helikopter betoni	<i>jo më pak se 1 copë</i>
<b>5.</b>	Skeleri	<i>jo më pak se 300 m<sup>2</sup></i>
<b>6.</b>	Betoniere 0.25 - 0.5 m <sup>3</sup>	<i>jo më pak se 2 copë</i>
<b>7.</b>	Vibrator Betoni	<i>jo më pak se 2 copë</i>
<b>8.</b>	Gjenerator	<i>jo më pak se 1 copë</i>
<b>9.</b>	Saldatriçe	<i>jo më pak se 1 copë</i>
<b>10.</b>	Matrapik	<i>jo më pak se 1 copë</i>

- b)** Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:
- Kokore – *jo më pak se 7 copë*
  - Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 1 copë*
  - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 1 copë*
  - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 5 copë*
- Për përbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkua të lart, në seksionin përkatës të Formularit Përbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpala publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**
- 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, dhe Foto e dukshme të mjetit.
  - 2- Për mjetet e siguruara me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, dhe Foto e dukshme të mjetit.
  - 3- Për paisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).
  - 4- Për paisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).

**2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën, ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objekt investimit, dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).**

#### **Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nemin 77** të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik<sup>1</sup>*” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të janë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesit kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kriterieve.”*

Në **nemin 39** “*Kërkesat të vecanta për kontratat për punë publike*” **pika 6/d** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “*6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:... d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën.”*

1. Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kriteret janë kritere detyruar edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme, ku vlerëson se **operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë automjetet, mjetet dhe pajisjet e kërkua me anë të cilave do të kryhet punimet (punime tarace, punimeve të brendshme, punime në sisteme të jashtme, etj.) dhe transporti i materialeve sipas zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e specifikimet teknike objekt kontrate**, ku sasia e tyre është kërkuar në përpjestim me natyrën e përmusat e këtyre punimeve objekt kontrate. **Njësia vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë prokurim.** Gjithashtu, Njësia e Prokurimit me qëllim përbushjen e kërkave minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë, në zbatim të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “*Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”*”, vendosi të kërkoi që operatorët ekonomik pjesëmarrës **duhet të disponojnë dhe pajisjet mbrojtëse për punonjësit të cilët do të angazhohen për kryerjen e punimeve objekt kontrate.**

2. Po ashtu, duke qënë se financimi për kryerjen e pagesave të punimeve objekt kontrate është i shtrirë në 3 (tre) vite, ndërsa realizimi i punimeve është parashikuar të përfundojë për 2 (dy) muaj, me qëllim shmangien e pretendimeve të operatorëve ekonomik gjatë realizimit të kontratës objekt prokurimi se nuk mund t’i kryejnë punimet brenda afatit për shkak të periudhës

së likujditetit, njësia e prokurimit ka vlerësuar t'u kërkojë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që të paraqesin një deklaratë ku shprehen se janë dakort me mënyrën e financimit dhe se punimet do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

### 2.3.9 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

#### Argumentimi:

Në nenin **15 pika 3/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: “**a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;**”

Njësia e prokurimit referuar të dhënavë teknike të projektit, ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej **2 (dy) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit**, vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

#### Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të janë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përjashtim bën vetëm Katalogu për materialet e kërkuar, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në dokumentacionin e projektit objekt prokurimi, ku ndër të tjerash janë dërguar dhe *Specifikit Teknikë* për punimet që do të kryhen, të cilat janë hartuar nga një shoqëri e licensuar në projektim, duke qënë se këto specifikime teknike plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “*Për Prokurimin publik<sup>1</sup>*”, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.

- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njësisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të proçedurës së prokurimit do të jetë **data 20.01.2023, ora 10.00, vendi: në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**.

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i proçedurave ligjore të prokurimit.**

**NJËSIA E PROKURIMIT**